

V E N D I M
Nr.5, datë 28.6.1995

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar	i “““
Manol Konomi,	Anëtar	i “““
Feti Gjilani,	Anëtar	i “““
Veli Budo,	Anëtar	i “““
Franc Jakova,	Anëtar	i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar	i “““
Metush Saraçi,	Anëtar	i “““
Zija Vuci,	Anëtar	i “““

me sekretare Drita Filto, më datat 7.6.1995 dhe 28.6.1995, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.8 Akti, që i përket :

K E R K U E S : MAQO ÇOMO, i përfaqësuar nga avokat Pirro Totozani.

O B J E K T I

Të deklarohet antikushtetues ligji nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist” si edhe në veçanti Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.454, datë 12.09.1994 “Për kriteret e përcaktimit të personave të nomenklaturës së lartë komuniste për efekt të statusit të ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relacionin përkatës,

V Ë R E N :

Ligji nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist” përmban kriteret dhe kushtet themelore që një person të quhet i dënuar apo i përndjekur politik si dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej tij. Neni 3 pika “e” parashikon që një kategori personash, të cilët megjithëse plotësojnë kushtet për t’iu njohur statusi nuk e përfitojnë këtë të drejtë. Kjo kategoripersonash parashikohet në nenin 5 të ligjit në fjalë, gërma “a” që përmban nomenklaturën e lartë komuniste sipas kriterëve të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Këshilli i Ministrave kriteret i ka përcaktuar me vendimin e tij nr.454, datë 12.09.1994.

Në këto kushte nuk mund të pretendohet se ligji është antikushtetues vetëm për faktin se çënon interesat e ankuesit.

Përsa i përket shkaqeve të ngritura në kërkesë se vendimi i mësipërm i Këshillit të Ministrave është antikushtetues, Gjykata e quan të nevojshme të sqarojë se Vendimi duke u mbështetur pikërisht në nenin 5 pika “a”, të ligjit duke caktuar kriteret, ka përcaktuar njëkohësisht cilat kategori të nomenklaturës së lartë komuniste nuk e përfitojnë statusin. Në fakt, në vendim thuhet se të drejtën e statusit e përfitojnë ish të dënuarit dhe të përndjekurit politikë nga sistemi komunist edhe të gjithë personat e nomenklaturës së lartë komuniste që janë dënuar me 10 vjet e lart heqje të lirisë për shkaqe politike, duke përjashtuar personat e asaj nomenklature, të cilët megjithëse të dënuar për shkaqe politike me 10 vjet e lart, kanë qenë qoftë dhe një herë për një periudhë sado të shkurtër kohe në postet e ministrit ose zëvendësmministrit të Punëve të Brendshme dhe të titullarit ose zëvendëstitullarit të Sigurimit të Shtetit gjatë gjithë periudhës së sistemit komunist. Për pasojë vendimi me kategorizimin e bërë i është përmbajtur kompetencave që i ka njohur ligji me delegim të shprehur.

Gjithashtu, në përmbajtjen e sipërme të vendimit të Këshillit të Ministrave, janë caktuar jo

persona por një kategori funksionesh që nuk e përfitojnë statusin. Kjo sepse as Ligji dhe as Vendimi nuk mund të merren me kategori personash të veçantë.

Pretendimi se Vendimi i Këshillit të Ministrave cënon barazinë e shtetasve para ligjit duke përjashtuar nga statusi të gjithë ato funksione që përmenden më sipër, nuk është i bazuar. Kjo sepse nuk mund të njihen në kushte të barabarta ata që kanë qenë në ato funksione që përmenden në Vendim me ata që nuk kanë qenë në ato funksione.

Në fund duhet përmendur se neni 18 i ligjit i njeh të drejtën Komisionit të krijuar për dhënien e statusit, që në bazë të propozimeve të Kryesisë Kombëtare të Shoqatës së ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë, të shqyrtojë raste të veçanta për dhënien e së drejtës të statusit, për të gjithë ata persona që përjashtohen nga ajo e drejtë në bazë të nenin 5 gërma “a” të ligjit të lartpërmendur dhe të vendimit të sipërpërmendur të Këshillit të Ministrave.

PËR KËTO ARSYE;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 24 pika "9" e 25 e 26 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës së ankuesit Maqo Çomo.

Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Kundër këtij vendimi votuan Rustem Gjata, Zija Vuci, Feti Gjilani, Alfred Karamuço.

MENDIMI I PAKICËS

Jemi kundër vendimit të shumicës dhe duke mbetur në pakicë parashtojmë këto arsye:

Pas disa ndryshimeve në Ligjin nr.7514, datë 30.9.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe reabilitimin e ish të dënuarve e të përndjekurve politikë”, me ligjin nr.7660, datë 14.1.1993 dhe të disa shtesave në këtë të fundit me ligjin nr.7719, datë 8.6.1993, Kuvendi Popullor ka miratuar ligjin nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”. Në nenin 1 të këtij ligji thuhet se statusi përmban kriteret dhe kushtet themelore që një person të quhet i dënuar apo i përndjekur politik, si dhe përcakton të drejtat e detyrimit në përputhje me shkallën e persekutimit. Ndërsa në nenin 3 të tij, në bazë të ligjeve të sipërme “Për pafajësinë ...”, është bërë ndarja e të përndjekurve politikë sipas këtij statusi, në pesë kategori. Në kategorinë e pestë (e) përfshihen personat, të cilët ndonëse i plotësojnë kushtet për t'u kategorizuar në një nga kategoritë e mësipërme, nuk përfitojnë të drejtën e këtij statusi.

Në nenin 5 të ligjit në fjalë janë grupuar sipas karakteristikave thelbësore të përbashkëta personat që nuk e përfitojnë statusin. Në shkronjën “a” përfshihet nomenklatura e lartë komuniste sipas kriterëve të miratuara nga Këshilli i Ministrave. Në bazë të këtij delegimi të bërë me ligj, Këshilli i Ministrave me vendimin e tij nr.454, datë 12.9.1994 “Për kriteret e përcaktimit të personave të nomenklaturës së lartë komuniste për efekt të statusit të ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, ka vendosur rregullin : “E përfitojnë të drejtën e statusit të ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist të gjithë personat e nomenklaturës së lartë komuniste që janë dënuar me 10 vjet e lart heqje të lirisë për shkaqe politike”. Në pikën 2 të vendimit janë përjashtuar nga e drejta e përfitimit të statusit personat e nomenklaturës së lartë komuniste, të cilët kanë qenë qoftë dhe një herë për një periudhë sado të shkurtër kohe në postet e ministrit ose zëvendësministrit të Punëve të Brendshme dhe të titullarit ose zëvendëstitullarit të Sigurimit të Shtetit.

Siç shihet efektet e ligjit për nomenklaturën e lartë komuniste shtrihen në kategorinë e personave të përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave.

Është e drejtë e ligjvënësit që të vendosi disa kufizime lidhur me të drejtën e përfitimit të statusit për kategori të caktuara personash. Por, këto kufizime ligjvënësi duhet t'i vendosi pa cënuar parimin kushtetues të barazisë së qytetarëve para ligjit, të sanksionuar në nenin 25 të ligjit nr.7692, datë 30.3.1993 “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”. Me nenin 5 shkronja “a” të Ligjit “Për statusin ...”, është cënuar parimi i barazisë. Ky cënim bie në sy duke krahasuar përmbajtjen e

shkronjës “a” me përmbajtjen e shkronjës “f” të nenit 5. Ndërsa për kategorinë e personave të shkronjës “a” të nenit 5 nuk vendoset asnjë kërkesë tjetër, përveç asaj të qënies në nomenklaturën e lartë, në shkronjën “f” të këtij neni për ish -krerët e lartë në kohën e pushtimit vihen disa kushte për t’u përjashtuar nga e drejta e statusit. Kështu, nuk mjafton qenia “kre i lartë”, por kërkohet që t’i përkasë organeve të dhunës, terrorit dhe spiunazhit, si dhe të ketë bashkëpunuar me pushtuesin. Dhe e gjithë kjo duhet të vërtetohet nga Gjykata e Kasacionit.

Mendojmë se për të respektuar parimin e barazisë para ligjit, për këto dy kategori personash (të shkronjës “a” dhe shkronjës “f”), duheshin vënë kushte ose kërkesa të ngjashme.

Është e vërtetë se Vendimi i Këshillit të Ministrave është në diskordancë me vetë ligjin, por, nga pikëpamja e së drejtës, ky vendim i nxjerrë në bazë dhe për zbatim të ligjit, nuk mund të quhet as kushtetues as i ligjshëm.

Përfundimisht, jemi të mendimit se duhet të shfuqizohet shkronja “a” e nenit 5 të Ligjit “Për statusin ...”, si antikushtetues dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.454, datë 12.09.1994. Kuvendi Popullor duhej të bënte një formulim tjetër duke respektuar kërkesat e nenit 25 të ligjit kushtetues.

A N E T A R
Zija Vuci

K R Y E T A R I
Rustem Gjata

MENDIMI I PAKICËS

Jam kundër këtij vendimi të shumicës, sepse argumentet, që do të parashtrohen më poshtë, vërtetojnë bindësisht se neni 2 i Vendimit Nr.454, datë 12 shtator 1994 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e caktimit të personave të nomenklaturës së lartë komuniste për efekte të statusit të ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë” është antikushtetues. Ky akt nënligjor, që është nxjerrë (por me një vonesë tejet të pajustificuar prej mbi trembëdhjetë muajsh) në bazë e për zbatimin e nenit 5, gërma “a”, të ligjit nr.7748, datë 29 korrik 1993, vjen në kundërshtim edhe me frymën e këtij ligji.

Në nenin 2 të këtij akti normativ nënligjor thuhet tekstualisht se : “Nuk përfitojnë të drejtën e statusit të ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist personat e nomenklaturës së lartë komuniste, të cilët, megjithëse kanë qenë dënuar nga organet gjyqësore të atij shteti diktatorial me 10 vjet e lart heqje të lirisë për shkaqe politike, kanë qenë, qoftë edhe një herë për një periudhë sado të shkurtër kohe në postet e ministrit ose zëvendësmministrit të Punëve të Brendshme dhe të titullarit ose zëvendëstitullarit të Sigurimit të Shtetit gjatë gjithë periudhës së sistemit komunist”.

Pra, kjo dispozitë nënligjore e Këshillit të Ministrave, duke pranuar kriterin e ngushtë të lartpërmendur e duke mos përcaktuar një kategorizim të diferencuar të hierarkisë së lartë të funksionarëve të shtetit diktatorial komunist të Shqipërisë, shkakton që vetëm mbi bazën e funksionit (krahasimisht jo aq të rëndësishëm e të ushtruar për një hark kohor të shkurtër), të mos u jepet statusi përkatës krejt legjitim edhe disa shtetasve të dënuar rëndë për arsye politike nga organet gjyqësore të partisë - shtet. Në fakt, gjatë shqyrtimit të kësaj çështje nga kjo Gjykatë Kushtetuese, u provua se kërkuesi Maqo Çomo ka qenë vetëm një vit Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Rendit e, si rrjedhojë e këtij funksioni, edhe zëvendësministër i ish-Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa më vonë ka vuajtur 20 vjet burgim dhe 10 vjet internim.

Për më tepër, kjo dispozitë nënligjore jep mundësinë që ta përfitojnë këtë status edhe shtetas që, para se të dënoheshin për arsye politike, kanë patur funksione partiake ose shtetërore shumë më të rëndësishme nga detyra e drejtorit të përgjithshëm të policisë së rendit në shtetin e diktaturës komuniste shqiptare.

Prandaj, meqënëse është shkelur parimi i barazisë së shtetasve në ligj dhe para ligjit, i cili është sanksionuar në nenin 25 të Ligjit Kushtetues nr.7692, datë 31 mars 1993, neni 2 i Vendimit nr.454, datë 12.9.1994 të Këshillit të Ministrave duhet të shpallet antikushtetues.

A N Ë T A R I
Feti Gjilani

MENDIMI I PAKICËS

Ligji nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, është në përputhje me Dispozitat Kryesore Kushtetuese.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.454, datë 12.9.1994 “Për kriteret e përcaktimit të personave të nomenklaturës së lartë komuniste për efekte të statusit të ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, është i kundërligjshëm dhe si i tillë duhet shfuqizuar, duke i parashtruar njëkohësisht Këshillit të Ministrave nevojën e nxjerrjes së një vendimi të ri.

Paligjshmëria e vendimit konsiston në këto drejtime :

a) Termi që përdor ligji (neni 5 shkronja “a”) “nomenklatura e lartë komuniste”, është i përgjithshëm, e si i tillë përfshin një masë të papërcaktuar personash. Ishte detyra ligjore e Këshillit të Ministrave, të përcaktonte rrethin e personave, që për efekt të zbatimit të ligjit do të kategorizoheshin në “nomenklaturën e lartë komuniste”, gjë që nuk është realizuar në vendim.

b) Sipas Ligjit (neni 3 shkronja “e” dhe neni 5 shkronja “a”) personat e kategorizuar në “nomenklaturën e lartë komuniste” kategorikisht përjashtohen nga e drejta e përfitimit të statusit edhe pse mund të jenë dënuar e përndjekur në një ose në të gjitha mënyrat e parashikuara nga neni 3 shkronja “a” dhe “d” e ligjit.

Megjithëse ligji i përjashton, ndesh me këtë ligj, Këshilli i Ministrave pranon që persona të “nomenklaturës së lartë” të përfitojnë statusin, duke bërë vetëm disa përjashtime.

c) Padrejtësisht Këshilli i Ministrave në Vendimin e tij përdor si “kriter” pranimi masën e dënimit. Ligji vetë për rastet e “nomenklaturës” nuk e pranon dënimin me heqje të lirisë si kusht apo kriter për pranim, përkundrazi shprehet qartë se kategoria e personave të lartpërmendur edhe pse në kushtet e dënimit me heqje të lirisë (ose kushtet e tjera) nuk e përfitojnë të drejtën e statusit të të përndjekurit politik (neni 3 gërma “e” e ligjit).

A N Ë T A R
Alfred Karamuço